



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.04.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2012, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 27, të datës 23.03.2012, paraqitur nga Drejtoria për Shërbime Publike, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 10, të Ligjit për Mbeturinat Nr.02/L-30, (Gazeta Zyrtare, Nr.23/2008), nenin 17, shkronja (e, f) dhe nenin 40, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), nenin 12.1 shkronja (d, dh) dhe nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën 2012-2015.
- II. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, përfshin:
 - Eliminimin e depove të egra;
 - Vazhdimin e vendosjes së kontejnerëve tjerë në gjithë territorin, sipas standardeve të parapara;
 - Riciklimin e mbeturinave;
 - Krijimin e një Ekodepoje dhe
 - Krijimin e një Kompanie komunale për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave, në të ardhmen.
- III. Obligohet, Drejtoria për Shërbime Publike për zbatimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, të cekur në pikat një (1) dhe dy (2) të vendimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për për SHP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

